

# Bilanci i energjisë elektrike


## Gjashtëmujori I-2016

**Tiranë, më 01 Shtator 2016:** Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, prodhimi neto vendas i energjisë elektrike është 4.065 GWh nga 3.758 GWh energji të prodhuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, duke shënuar rritje të prodhimit prej 8,2 përqind.

Kontribut në rritjen e prodhimit neto vendas kanë dhënë hidrocentralet private dhe koncensionare, prodhimi i të cilave gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016 është rritur me 35,9 përqind krahasuar me të njëjtin gjashtëmujor të vitit 2015. Hidrocentralet publike rezultojnë të kenë ulje të prodhimit në këtë periudhë me 1,2 përqind.

Rritja e prodhimit të energjisë elektrike në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 ka ndikuar në rënien e importeve dhe rritjen e eksporteve të energjisë elektrike duke sjellë rënie të importeve bruto (energji në marrje) me 4,7 përqind dhe rritje të eksporteve bruto (energji në dhënie) me 53,3 përqind, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.

**Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto**



**Për publikim 01/09/2016**

Tab. 1 Balanci i energjisë elektrike

MWh		Gj I 2015	Gj I 2016
Treguesit			
<b>A</b>	<b>Energji në dispozicion (A=1+2-3)</b>	<b>3,730,852</b>	<b>3,551,147</b>
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	3,758,341	4,064,834
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	3,758,341	4,064,834
a	Publike (a=a.1-a.2)	2,811,798	2,778,441
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	2,826,798	2,812,204
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	15,000	33,763
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	946,542	1,286,393
1.3	Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	0	0
2	Importi bruto (energji në marrje)	813,806	775,692
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	841,295	1,289,378
<b>B</b>	<b>Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)</b>	<b>3,730,852</b>	<b>3,551,147</b>
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	1,166,973	1,036,574
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	92,518	105,852
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) <sup>1</sup>	1,074,455	930,722
a	Humbjet teknike në shpërndarje	699,624	676,563
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje <sup>2</sup>	374,831	254,159
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	2,563,879	2,514,573
2.1	Familjarë	1,308,129	1,324,377
2.2	Jo Familjarë	1,255,750	1,190,196

<sup>1</sup> Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike

<sup>2</sup> Humbjet jo teknike përbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Hidrocentralet publike kanë realizuar 68,4 përqind të prodhimit të energjisë elektrike për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 nga 74,8 përqind që realizuan në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015. Kontributi i hidrocentraleve private dhe koncensionare në prodhimin neto vendas të energjisë elektrike është 31,6 përqind nga 25,2 përqind që zinte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje)**, në gjashtëmujin e parë të vitit 2016, rezultoi me rënie duke arritur vlerën 776 GWh nga 814 GWh në gjashtëmujin e parë të vitit 2015.

**Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie)** arriti 1. 289 GWh në gjashtëmujin e parë të vitit 2016 nga 841 GWh që përbënte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Njësoj si gjashtëmuji i parë i vitit 2015, vendi rezulton të jetë eksportues neto i energjisë elektrike gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2016, por vihet re një rritje e vlerës të shkëmbimit tregtar në 514 GWh nga 27 GWh që rezultoi në gjashtëmujin e parë 2015.


**Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike**



Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2016 humbjet në rrjet kanë rënë me 11,2 përqind, ku ndikim në këtë rënie kanë patur uljet e humbjeve në shpërndarje të cilat përbëjnë 89,8 përqind të humbjeve gjithsej në rrjet. Në këtë periudhë, **humbjet në rrjet** janë 1.037 GWh nga 1.167 GWh që ishin në gjashtëmujin e parë të vitit 2015.

**Humbjet në shpërndarje** kanë rënë 13,4 përqind krahasur me gjashtëmujin e parë të vitit të kaluar. Ndryshe paraqitet situata për **humbjet në transmetim**, të cilat u rritën me 14,4 përqind duke përbërë 10,2 përqind të humbjeve në rrjet nga 7,9 përqind të humbjeve gjithsej në rrjet që zinin në gjashtëmujin e parë të vitit 2015.

**Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët**




**Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët** në gjashtëmujin e parë të vitit 2016 është 2.515 GWh nga 2.564 GWh që ishte në gjashtëmujin e parë të vitit 2015. Gjatë kësaj periudhe ky tregues ka shënuar rënie prej 1,9 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndikim në rënien e përdorimit të energjisë elektrike nga konsumatorët kanë pasur **konsumatorët jo familjarë** ku përdorimi i energjisë nga ky grup konsumatorësh pati rënie prej 5,2 përqind në gjashtëmujin e parë të 2016 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015.

Situata ndryshon për **konsumatorët familjarë**, ku përdorimi i energjisë elektrike nga ky grup konsumatorësh u rrit me 1,2 përqind krahasuar me gjashtëmujin e parë të vitit 2015.

**Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët**



# Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudhë gjashtëmuji nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSHEE sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen furnizimin, shitjen e energjisë elektrike si edhe operimin dhe menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
  - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
  - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
  - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

## **Përkufizimet e treguesve bazë**

**Energji në dispozicion** i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

**Prodhimi neto vendas** llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

**Energji termo** i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

**Energji hidro** i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

**Humbjet dhe konsumi vetjak** i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

**Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë** u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liçensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSHEE-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

**Prodhues të tjerë** i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.

**Shkëmbimi i energjisë elektrike** i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

**Konsumi i energjisë elektrike** i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

**Humbjet në rrjet** përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. Humbjet teknike në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSHEE sh.a. Humbjet jo teknike i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

**Përdorimi nga konsumatorët** është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

**Familjarët** i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

**Jo familjarët** i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshirë konsumin nga familjarët.